



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 47, Datë 11.02.2021

MBI

PLOTËSIMIN E KUSHTIT TË VENDIMIT NR. 114, Datë 22.07.2019 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “S.P.E GJADËR” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “GJADËR NR. 1/1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 2134 KW, HEC “GJADËR NR. 1/2” ME KAPACITET TË INSTALUAR 4406 KW, HEC “GJADËR NR. 2” ME KAPACITET TË INSTALUAR 2983 KW, HEC “GJADËR NR. 3”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 3874 KW, HEC “GJADËR NR. 4” ME KAPACITET TË INSTALUAR 5922 KW, HEC “GJADËR NR. 5” ME KAPACITET TË INSTALUAR 5619 KW, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 24938 KW, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “a”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, dhe nenit 13, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 11.02.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 20/1-1 Prot., datë 08.02.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqytjes, lidhur me plotësimin e kushtit të vendimit nr. 114, datë 22.07.2019, mbi licencimin e shoqërisë “S.P.E Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- ERE me vendimin nr. 114, datë 22.07.2019, vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “S.P.E Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga: “HEC Gjadër Nr.1/1” me kapacitet të instaluar 2134 kW, “HEC Gjadër Nr. 1/2” me kapacitet të instaluar 4406 kW, “HEC Gjadër Nr. 2” me kapacitet të instaluar 2983 kW, “HEC Gjadër Nr. 3” me kapacitet të instaluar 3874 kW, “HEC Gjadër Nr. 4” me kapacitet të instaluar 5922 kW, “HEC Gjadër Nr. 5” me kapacitet të instaluar 5619 kW; me

kapacitet të instaluar total 24938 kW, për një afat 29 vjet e 2 muaj, ndryshuar me vendimin nr. 239, date 23.12.2019.

- Kushtet e vendimeve të sipërcituara qëndronin në ndërtimin e veprës, vënien e saj në punë dhe lidheshin gjithashtu me pretendimin e shoqërisë se për vitet e humbura të koncesionit do t'i kërkonte në vijim Autoritetit Kontraktor një kontratë shtesë e cila do të mundësonte zgjatjen e periudhës së koncesionit, periudhë kjo e humbur për shkak të aplikimeve në AZHT dhe problematikave të hasura, për të cilat shoqëria ka bërë me dije edhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).
- Sa konstatuar, pavarësisht gjithë përpjekjeve që shoqëria kishte bërë për të plotësuar këtë kusht, pra aplikimin për lejen e ndërtimit që nga fillimet e aplikimit për licencë në ERE, rezultoi se plotësimi i kushteve të vendimeve të ERE-s, nuk varej nga vullneti i shoqërisë së licencuar, por nga ai i institucioneve shtetërore.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 71/1 prot., datë 18.01.2021, mbërriti për dijeni komunikimi i Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL sh.a.) drejtuar shoqërisë “S.P.E Gjadër” sh.p.k. me anë të së cilës kjo e fundit i kthen përgjigje kërkesës së shoqërisë për lidhjen e kontratës së shitjes së energjisë elektrike për HEC-et në lumin Gjadër, duke i thënë se më parë duhet të plotësojë kushtet e vendimit të licencimit nr. 114, datë 22.07.2019, i ndryshuar.
- Nisur nga sa më sipër, ERE me shkresën nr.71/2 prot., datë 01.02.2021, iu drejtua shoqërisë “S.P.E Gjadër” sh.p.k., duke i kërkuar informacion në lidhje me kërkesën drejtuar FTL sh.a., për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes, në lidhje me ndërtimin e veprës dhe kohën e parashikuar për vënien në punë të HEC-eve Gjadër, duke qenë me herët në dije në lidhje me problematikën e lejes së ndërtimit referuar të cilës janë orientuar edhe kushtet e vendimeve respektive.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “S.P.E Gjadër” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 71/3 prot., datë 04.02.2021, ka përcjellë në ERE informacion lidhur me sa kërkuar duke bërë me dije se aktualisht ndodhet në fund të testimit të veprës dhe në vënien në operim të saj, fakt i cili i është bërë me dije dhe vetë MIE-s si dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore me shkresën nr. 338 dt. 01.02.2021. Këtë shkresë shoqëria e ka depozituar edhe në ERE.
- Shoqëria vijon duke argumentuar se vonesa në lidhjen e kontratës me FTL sh.a., e vë në vështirësi të mëdha financiare pas përfundimit të një vepre për të cilin është kryer një investim shumë i madh.
- Nisur nga sa më sipër duke qenë se kushti i vendosur në vendimin nr. 239 datë 23.12.2019 *“Përndryshimin e Vendimit nr. 114 dt. 22.07.2019 për licencimin e shoqërisë S.P.E Gjadër”* lidhej pikërisht me shtyrjen e afatit të punimeve të veprës me një kontratë shtesë koncesioni dhe aktualisht jemi përpara faktit të dokumentuar nga shoqëria për përfundimin e ndërtimit të saj, dhe mbetjen e njëjtë të afateve të mbetura të koncesionit pra **29 vjet e 2 muaj** siç llogaritur në momentin e licencimit të shoqërisë me vendimin nr. 114, datë 22.07.2019, kushti i vendosur në këtë vendim është plotësuar nga ana e shoqërisë.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të ndryshojë pikën 1 të vendimit të ERE nr. 114, datë 22.07.2019, i ndryshuar si vijon:
 - a. Të licencojë shoqërinë “S.P.E Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga: “HEC Gjadër Nr.1/1” me kapacitet të instaluar 2134 kW, “HEC Gjadër Nr. 1/2” me kapacitet të instaluar 4406 kW, “HEC Gjadër Nr. 2” me kapacitet të instaluar 2983 kW, “Hec Gjadër Nr. 3” me kapacitet të instaluar 3874 kW, “HEC Gjadër Nr. 4” me kapacitet të instaluar 5922 kW, “HEC Gjadër nr. 5” me kapacitet të instaluar 5619 kW; me kapacitet të instaluar total 24938 kW, për një afat 29 vjet e 2 muaj.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI